



Programi rajonal mbi demokracinë vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD)



This project is financed
by European Union

Empowered lives.
Resilient nations.

THIRRJE PUBLIKE PËR PJESËMARRJE TË PËRFAQËSUESIT TË SHOQËRISË CIVILE NË KOMISIONIN E VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE (OSHC) NË KUADËR TË PROJEKTIT RAJONAL PËR DEMOKRACI VENDORE (ReLOaD) NË 12 BASHKITË PARTNERE¹

Qëllimi kryesor i projektit ReLOaD, i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga UNDP, është të forcojë demokracinë pjesëmarrëse dhe procesin e integritimit në BE në vendet e Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet fuqizimit të shoqërisë civile, duke mundësuar pjesëmarrjen e saj aktive në vendimmarrje si dhe nxitjen dhe krijimin e një mjedisi ligjor dhe financiar inkurajues për shoqërinë civile.

Projekti ReLOaD ka partneritet me dymbëdhjetë bashki në Shqipëri, konkretisht me bashkitë: Durrës, Dibër, Elbasan, Librazhd, Lezhë, Përmet, Korçë, Tropojë, Roskovec, Tiranë, Prrenjës dhe Shkodër dhe bashkëpunon për adoptimin e një qasjeje transparente, të orientuar drejt zhvillimit dhe të bazuar në projekte për financimin e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve).

Në këtë kuadër, projekti ReLOaD në Shqipëri dhe 12 bashkitë partnere, kanë hapur Thirrjen e dytë publike për organizatat e shoqërisë civile. Nëpërmjet kësaj thirrjeje ftohen OSHC-të të aplikojnë me projekte sipas kriterëve të shpalljeve publike të secilës bashki. Me qëllim, vlerësimin e projekteve të propozuara nga OSHC-të ngrihet një komision vlerësimi në secilën bashki, ku ka edhe një përfaqësues të OSHC-ve.

Për sa më sipër, dhe për të siguruar një proces transparent dhe të hapur të përzgjedhjes së projekteve të OSHC-ve, projekti ReLOaD **shpall Thirrjen Publike për praninë e një përfaqësuesi të OSHC-ve në Komisionet e Vlerësimit të aplikimeve të OSHC-ve në 12 bashkitë partnere në Shqipëri.**

Pas dorëzimit të aplikimeve nga OSHC-të, procesi i vlerësimit pritet të mbahet në muajt Mars - Prill 2019. Vlerësimi do të kryhet sipas një Udhëzuesi të përgatitur nga projekti ReLOaD dhe mund të zgjasë 2-3 ditë për secilën bashki.

Përfaqësuesi i OSHC-së në Komisionin e Vlerësimit do të ketë këto detyra dhe përgjegjësi:

- Përfaqësuesi i OSHC-ve do të jetë anëtar i Komisionit të Vlerësimit me të drejtë vote, dhe do të kryejë vlerësim në përputhje me rregulloret e Projektit ReLOaD;
- Përfaqësuesi i OSHC-ve duhet të marrë pjesë në Komisionin e Vlerësimit nga fillimi deri në fund të procesit;

¹ Durrës, Dibër, Elbasan, Librazhd, Lezhë, Përmet, Korçë, Tropojë, Roskovec, Tiranë, Prrenjës dhe Shkodër

- Përfaqësuesi i OSHC-ve do të nënshkruajë një deklaratë konfidencialiteti dhe paanshmërie;
- Përfaqësuesi i OSHC-ve do të nënshkruajë bashkërisht me anëtarët e tjerë raportin e Komisionit të Vlerësimit dhe do të konfirmojë gjetjet e dala nga procesi, si dhe do të japë komente shtesë lidhur me punën e komisionit të vlerësimit, nëse dhe kur është e nevojshme.

Të interesuarit për të qenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit duhet të jenë anëtarë dhe/ose punonjës me orar të plotë të OSHC-ve të themeluara/regjistruara në Shqipëri dhe duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Përvojë dhe aftësi të mëparshme në kryerjen e vlerësimit të paanshëm, të drejtë dhe transparent të projekt propozimeve të OShC-ve. Përvoja me skemat e dhënies së granteve të BE-së do të konsiderohet si përparësi;
- Përvojë në përgatitjen dhe/ose zbatimin e projekteve të financuara nga fondet publike, sidomos në nivel vendor;
- Njohja e bazës ligjore, dokumenteve strategjike, politikave dhe metodologjive në fushën e dhënies së fondeve publike për OShC-të;
- Njohja e parimeve të Ciklit të Menaxhimit të Projekteve (PCM);
- Njohja e gjuhës shqipe dhe angleze në të folur dhe të shkruar;

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim në adresën: registry.al@undp.org:

- CV (duke specifikuar përvojën e mëparshme në fushat e sipërpërmendura);
- Letër Motivimi (duke shprehur interesin për pjesëmarrje në Komisionin e Vlerësimit, si dhe konfirmimin e disponueshmërisë për procesin e vlerësimit, **duke specifikuar edhe bashkinë ku preferon të përfshihet**);
- Deklaratë nga përfaqësuesi ligjor i OSHC-së që autorizon kandidatin për të përfaqësuar OSHC-në përkatëse në Komisionin e Vlerësimit.

Përfaqësuesi i OSHC-s duhet të jetë i gatshëm të punojë pro bono/pa pagesë. Projekti do të mbulojë shpenzimet bazë, duke përfshirë transportin, akomodimin dhe ushqimin gjatë procesit të vlerësimit.

OShC-të nga e cila kandidati i përzgjedhur për Komisionin e Vlerësimit është anëtar dhe/ose punonjës NUK do kenë të drejtë të aplikojnë (as si aplikues kryesor as si OSHC partnere) në thirrjet publike për dorëzimin e projekt propozimeve të OSHC-ve në kuadër të projektit ReLOaD në bashkinë për të cilën kandidati është përzgjedhur për të qenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është data 22 Shkurt 2019, ora 17:00.

Për informacion të mëtejshëm, ju lutem mos hezitoni të kontaktoni znj. Eglantina Gollaj (eglantina.gollaj@undp.org).